

Bashkia: SKRAPAR

Kryetar: NESIM SPAHIU

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Nëpërmjet një investimi me vlerë 8 milionë dollarë, do të realizohet një rrjet i ri për ujërat e zeza dhe të bardha, si dhe rrjetin e ujësjellësit në territorin e bashkisë, i cili sipas projektit duke marrë parasysh dhe shtimin e popullsisë për 25 vjet do të ofrojë ujë të pijshëm për një popullsi me shumë se 15 mijë banorë
2. Do të ndërhyet në infrastrukturë rrugore duke filluar nga sheshi i qytetit, tregu i ri dhe rruga deri tek shtypëshkronja
3. Do të përfitojë qyteti ujë 15-18 orë në ditë me një kosto shpenzimi për shfrytëzim të papërfillshme
4. Do të vazhdojnë të ndërtohen mure dekorative duke kaluar nga lagja “2 dhjetori” drejt lagjes “5 shtatori”
5. Do të ndërtohet segmenti Çorovodë-Orizaj
6. Do të shtrohet me asfalt rruga “Alush Grepecka
7. Do të zgjerohet ura e spitalit në Çorovodë
8. Do të sigurohet mirëmbajtje për rrjetin rrugor të zonës Çorovodë - Përmet
9. Do të sigurohet uji i pijshëm në të gjithë komunitetin, në Zogas, Kalanjas dhe Dhores
10. Do të krijohen akse të reja rrugore në Skrapar
11. Do të sigurohet mirëmbajtje për rrjetin rrugor të zonës Potom- Zogas
12. Do të ketë trajtim për ujëmbledhësit e zones në Skrapar me qëllim që të bëhen efektiv për komunitetin
13. Do të zgjidhet problematika e ujit të pijshëm në çdo fshat në Skrapar sipas problematikës specifike
14. Do të ketë mirëmbajtje për rrugën dhe askesimin e saj gjatë gjithë vitit, në Nishicë
15. Do të zgjidhet problemi i energjisë elektrike në Osojë, Qafë, Visockë, Polenë
16. Do të përmirësohen kushtet në shërbimin shëndetësor, në Nishicë
17. Do të krijohet një brigadë ndërtimi për mirëmbajtjen e rrugëve deri në qendrat e fshatrave Përparim, Dobrushë dhe Selan
18. Do të ndërtohet ura në fshatin Dobrushë
19. Do të zgjidhet problemi i energjisë elektrike, në Vëndreshë të Parë dhe Spatharë
20. Do të rikonstruktohet rruga, në Vëndreshë të Parë dhe Spatharë
21. Do të zgjidhet në mënyrë ligjore, në respekt të ligjeve të shteti, konflikti i banorëve për ujin e pijshëm në Vëndreshë
22. Do të sigurohet mirëmbajtje për rrjetin rrugor në Çepan
23. Do të sigurohet ujë i pijshëm për gjithë banorët e fshatit Blezënckë
24. Do të krijohet një brigadë për mirëmbajtjen e rrugëve, në Straveckë
25. Do të vendoset uji i pijshëm në Barçkë

26. Do të kryhet pastrimi i rrugës në Barçkë
27. Do të sigurohet infrastrukturë më e mirë rrugore në zonat Leshnje dhe Gostënckë
28. Do të sigurohet mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit, në zonat Leshnje dhe Gostënckë
29. Të gjitha firmat që aktualisht shfrytëzojnë rezervat minerare në Leshnje do të investojnë në infrastrukturën e saj, në rrugët lidhëse midis fshatrave
30. Të gjitha firmat që aktualisht shfrytëzojnë rezervat minerare në Leshnje do të investojnë në ujësjellës dhe disiplinim të ujërave të zeza
31. Do tu rikthehet Qendra Shëndetësore banorëve të fshatit Leshnje
32. Do të ngrihet brigadë për mirëmbajtjen e rrugëve
33. Do të vihet në efikasë ujësjellësi i Zhepës dhe gjithë ujësjellësat e tjerë

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të kryhet punësimi i të rinjëve të arsimuar
2. Do të rikonstruktohet shkolla 9-vjeçare” Kahreman Ylli”
3. Do të rikonstruktohet plotësisht çerdhja dhe kopshti në lagjen “2 Dhjetori”
4. Do të sigurohet shkollim në kushte më të mira për fëmijët në Nishicë
5. Do të krijohen ambiente të përshtatshëm për shkollën e Dobrushës dhe gjithashtu do të vendosen mësues për shkollën në Selan
6. Do të rikonstruktohen pjesërisht shkollat e Zhepës dhe Grevës dhe do të kryhet mirëmbajtja e shkollave në fshatrat e tjerë

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të hapen kurse formuese për gratë dhe vajzat, ku ato do të trajnohen për të ofruar shërbime në fushën e turizmit dhe më pas të punësohen ose të vetëpunësohen duke hapur bizneset e tyre
2. Do të hapet një agjenci turistike në bashki
3. Do të kryhet asfaltimi i rrugës së Tomorrit si një potencial shumë i fuqishëm turistik dhe për të rritur fluksin turistik
4. Rrugët për zhvillimin e turizmit do të jenë: promovimi i zonës dhe i resurseve të saj turistike, investimet në akseset rrugore nacionale: si Corovode-Permet, Corovode-Zhepe, Corovodë-Korçë si dhe përmirësimin të rrjetit rrugor të brendshëm
5. Do të gjelbërohen të gjitha rrugët dhe lagjet e qytetit
6. Do të vendosen kosha për mbeturinat në Skrapar do të synojmë që në të gjithë territorin e bashkisë të kemi një rrjet koshash për mbeturinat dhe këto të merren dhe të depozitohen në landfillin e bashkisë
7. Mbetjet, në Skrapar, do të menaxhohen nga bashkia
8. Do të mbështetet shndërrimi i zonës në Skrapar në një destinacion turistik, nëpërmjet investimit, promovimit dhe krijimit të produkteve natyrale bio
9. Do të punohet në shndërrimin e zonës së Sharovës në një destinacion turistik, nëpërmjet investimeve, promovimit dhe krijimit të produkteve natyrale bio

10. Do të ndërtohet infrastrukturë turistike në zonën e kanoneve të Osumit, si dhe në ujëvarën e Bogovës, që do ta shndërrojë zonën shumë shpejt në një destinacion të preferuar turistik
11. Do të kryhet zhvillimi i zonës së Therepelit nëpërmjet turizmit: promovimit të zonës, resurseve të saj turistike, ndërtimi i infrastrukturës turistike me anë të investimeve në sinjalistikë në segmentin e kanioneve dhe Ujëvarën e Bogovës
12. Do të kryhet promovim i resurseve në zonën e Blezënckës, si mundësia më e mirë për zhvillimin ekonomik të zonës
13. Do të rikonstruktohet infrastruktura turistike në Çepan
14. Do të sigurohen fidanë cilësore si dhe do të kryhen kontrata me fermerët për shitjen e prodhimeve të tyre në Çepan
15. Do të kenë logot e veta identifikuese të zonës produktet në fshatrat Muzhakë, Rog dhe Zabërzan
16. Për punësim në Çepan do ti jepet përmarësi Agro – turizmit, një formë e re për punësimin dhe zhvillimin e zonës

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të hapet një fabrikë qumështi në Çorovodë për grumbullimin dhe përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij për të grumbulluar qumështin e gjithë luginës së Osumit
2. Do të hapet një mikrofermë prej 35 ha që do të krijojë një model për zhvillimin e bujqësisë
3. Do të hapet një minifabrike për përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij në bashki, që do t'iu mundësojë fermerëve të Mollasit dhe Gradecit të kenë një treg për produktet e tyre
4. Do të ndërtohet një pikë grumbullimi ku do të sjellin fidanë cilësorë për tja shpërndarë fermerëve të zonës, duke nënshkruar kontrata me ta për prodhimet e tyre sipas çmimit të tregut, në zonat Mollas dhe Gradeckë
5. Do të ndërtohet një pikë grumbullimi ku do të sjellin fidanë cilësorë për tja shpërndarë fermerëve të zonës, duke nënshkruar kontrata me ta për prodhimet e tyre sipas çmimit të tregut, në zonat Liqedh dhe Grepckë
6. Do të realizohet rehabilitimi i rezervuarit për ujitje, në Nishicë
7. Do të rritet numri i përfituesve nga subvencionet në Orizaj
8. Do të sigurohet krijimi i produkteve orgjinale bio në Zogas, Kalanjas dhe Dhores
9. Hapja e fabrikës së qumështit në Çorovodë për grumbullimin dhe përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij do të ndihmojë dhe banorët në Zogas, Kalanjas dhe Dhores
10. Do të mbështet zhvillimi i zonës së Rovicës përmes turizmit dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë, në krijimin e produkteve bio, në respekt të traditës; Ndërkohë, ndërtimi i minifabrikës për përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij do të ndihmojë zonën që qumështi të ketë një treg e të garantojë të ardhura për këta fermerë
11. Do të zgjidhet problemi i tregut të qumështit në Osojë, Qafë, Visockë, Polenë, nëpërmjet minifabrikës për përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij në Çorovodë, e cila do të grumbullojë gjithë qumështin e zonës sipas çmimit të tregut

12. Do të sigurohen fidanë cilësorë si dhe kontrata me fermerët për shitjen e prodhimeve të tyre në Zogas, Kalanjas dhe Dhores
13. Do të ketë mbështetje me fidanë cilësorë për bujqësinë dhe do të sigurohet treg për produktet blegtorale, në Nishicë
14. Do të punohet me zhvillimin e Munushtirit, nëpërmjet ngritjes së një tregu për grumbullimin e frutave
15. Do të ngrihet një pikë grumbullimi në Bogovë për qumështin e fshatrave
16. Do të ngrihet një pikë për grumbullimin e frutave në fshatrat Përparim, Dobrushë dhe Selan
17. Do të sigurohen fidanë cilësorë dhe kontrata reale për prodhimet e fermerëve në fshatrat Përparim, Dobrushë dhe Selan
18. Do të ketë subvencione jo për krerë, por për njësi prodhimi qumështi dhe mishi në fshatrat Përparim, Dobrushë dhe Selan
19. Do të vendoset subvencioni në blegtori për litër, në Vëndreshë të Parë dhe Spatharë
20. Do të zgjidhet problemi i ujit për vaditje, në Vëndreshë të Parë dhe Spatharë
21. Do të mbështeten resurset turistike në Çepan, si produkte bio me cilësi të lartë
22. Do të vendoset uji për vaditje në Barçkë
23. Hapja e pikës së grumbullimit të qumështit në bashki do të ndihmojë dhe zonat e Leshnje dhe Gostëncë pasi do të ofrojnë një treg alternativ për fermerët
24. Do t'u ofrohet subvencione fermerëve për shtimin e prodhimit, në Leshnje
25. Do të ndihmohen fermerët në Gjerbës për të shtuar kapacitetet prodhuese, pasi zona është e njohur për prodhimtarinë e saj në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të krijohet një komision vlerësimi me pjesëmarrje komunitare të cilët do të vlerësojnë figura të rëndësishme në bashki, kontributin e tyre dhe më pas do të propozojnë për dhënie titujsh pranë këshillit bashkiak; Për ta bërë sa më transparent këtë proces, në faqen e internetit të bashkisë, do të aktivizohet një rubrikë për të tërhequr opinion qytetar si pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi
2. Do të realizohen dëgjesa publike një herë në vit në Qendrat Administrative me komunitetin dhe do të ketë transparencë për aktivitetin e bashkisë
3. Do të organizohen dëgjesa publike në çdo qendër ish-komune me qëllim që gjithë komuniteti i bashkisë Skrapar në të gjithë territorin e saj, të njihet me buxhetin, me planin urbanistik, të shprehin objeksionet e tyre, të gjitha këto të mbahen shënim nga ekspertet dhe këto zëra të merren në konsideratë nga ekspertët e fushave
4. Vendimet e Këshillit Bashkiak do të bëhen transparente në faqen zyrtare të bashkisë me qëllim që komuniteti të informohet me atë që ndodh në bashki
5. Do të ketë transparencë për punën e bashkisë nëpërmjet dëgjesave publike një herë në vit

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të sigurohet mbështetje për veteranët

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të zgjidhet problemi i punësimit në Sharovë nëpërmjet punësimit në fabrikën e kepucëve
2. Do të bashkëpunohet me firma që punojnë në zonë për investime komunitare, për zonat e Leshnje dhe Gostënckë
3. Do të ketë trajtim ligjor dhe zgjidhje konkrete të konflikteve për të gjitha mosmarrëveshjet në komunitet